



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Sekretari i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "ZhanD'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë \_\_\_/\_\_\_2023

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E  
ULËT DREJTUESE**

Ne zbatim të nenit 26 të Ligjit nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II dhe të III-të të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 "Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele dhe të Ngritjes në Detyrë, për pozicionin:

**1 (një) Përgjegjës, i Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Kategoria e pagës III-a).**

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË !**

Pozicioni i mësipërm i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e Lëvizjes Paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

**Afati për aplikimi për Lëvizje Paralele është deri në datë: 12.06.2023**

**Afati për aplikim për Ngritje në Detyrë është deri në Datë: 15.06.2023**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Përgjegjës, në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve.**

1. Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve, është pjesë e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve. Objektivi kryesor i punës së këtij Sektori është implementimi dhe zhvillimi i një strategjie për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informacionit nëpërmjet programeve që ka në zotërim Institucioni i Avokatit të Popullit si dhe pritja, komunikimi, pranimi/këshillimi i ankesave të qytetarëve, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta

- të organeve të administratës publike si dhe përpunimi i statistikave të institucionit.
2. Administrimi i rrjetit kompjuterik ,rrjetit telefonik si dhe ruajtjen e bazave të të dhënave, nëpërmjet strukturave funksionale për përdorimin sa më afatgjatë të programit dhe mirëmbajtja e tyre. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit në lidhje me përdorimin e programeve etj.
  3. Administrimi dhe suporti teknik referuar problematikave të serverave , pajisjeve elektronike / elektrike si dhe mirëmbajtja e tyre.
  4. Menaxhimi i rrjetit si dhe të e-mailit të brendshëm në bashkpunim me AKSHI-in dhe mirëmbajtja e tyre.
  5. Menaxhimi i faqes së Web-it të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe publikimet në faqe.
  6. Përpunimi i statistikave të ndryshme në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Avokati i Popullit si dhe përpunimi i të dhënave të regjistruara në sistemin e Docu-Live.
  7. Menaxhimi i organizimeve të takimeve/trajnimeve online të zhvilluara në të gjitha platformat elektronike;
  8. Drejtimi dhe koordinimi i zyrës qendrore të pritjes dhe i zyrave rajonale te Pritjes së Qytetarit.
  9. Përgatitja e raporteve që lidhen me sektorin.
  10. Zbatimi me përpikmëri i të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga Urdhërat e Brendshëm të eprorit direkt dhe të Titullarit të Institucionit;

## **I. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm Nëpunësit Civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e Shërbimit Civil.

### **1. Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:**

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga institucioni);
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Shumë Mirë” ose “Mirë”.

### **2. Kriteret e Veçanta**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkenca inxhinieri elektrike/elektronike/informatike. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në Administratë;
3. Të zotërojnë njohuri shumë të mira në fushën e specialitetit. Vlerësohen studimet pasuniversitare;
4. Të ketë njohuri në sisteme operative, pajisjeve hardware etj;
5. Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve;
6. Të ketë aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse;
7. Të ketë aftësi shume te mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
8. Të ketë njohuri të gjuhës angleze të vërtetuar me dëshminë përkatëse;
9. Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara.

### **3. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijojnë:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjqësore;
8. Vlerësimin e fundit në punë;
9. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit Brenda datës 12.06.2023.**

### **4. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brënda **3 (tre)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brënda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

**Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista**

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin “Përgjegjës, në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve” do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
3. Njohuri mbi Ligjin nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
4. Njohuri mbi Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
5. Njohuri mbi Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Njohuri mbi legjislacionin për krimin kibernetik ([www.akshi.gov.al/Legjislacioni](http://www.akshi.gov.al/Legjislacioni)).
7. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.
8. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

## 5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Dokumentacionin e dorëzuar, deri në **40 pikë**.
2. Intervistën e strukturuar, **deri në 60 pikë**.

### Vlerësimi i dokumentacionit:

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.

## **II. Ngritja në Detyrë**

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, atëhere ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Për procedurën e Ngritjes në Detyrë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm Nënpunës Civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një Institucion tjetër të Shërbimit Civil, që plotësojnë kushtet për Ngritjen në Detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

### **1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Procedurën e Ngritjes në Detyrë janë:**

2. Të jetë Nënpunës Civil i konfirmuar në kategorinë ekzekutive;
3. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni);
4. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë Mirë”.

### **2. Kriteret e Veçanta**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkenca inxhinieri elektrike/elektronike/informatike. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi);
2. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në Administratë;
3. Të zotërojnë njohuri shumë të mira në fushën e specialitetit. Vlerësohen studimet pasuniversitare;
4. Të ketë njohuri në sisteme operative, pajisjeve hardware etj;
5. Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve;
6. Të ketë aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse;
7. Të ketë aftësi shume te mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
8. Të ketë njohuri të gjuhës angleze të vërtetuar me dëshminë përkatëse;
9. Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara.

### **3. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
- b. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
- c. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit në punë;
- i. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
- j. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit Brenda dates 15.06.2023.**

#### **4. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara nëshpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e

kandidatëve që plotësojnë kushtet e Ngritjes në Detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjegje brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

#### **Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët**

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin “Përgjegjës, në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve” do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

3. Njohuri mbi Ligjin nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
4. Njohuri mbi Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
5. Njohuri mbi Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Njohuri mbi legjislacionin për krimin kibernetik ([www.akshi.gov.al/Legjislacioni](http://www.akshi.gov.al/Legjislacioni)).
7. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.
8. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

## 5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

### Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, **deri në 40 pikë**
- Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, **deri në 40 pikë**
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, **deri në 20 pikë.**

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>

## 6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.